

Për pajisjen me leje punimesh duhet të paraqisni pranë A.Rr.Sh-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Planimetri të detajuar të segmentit ku mendoni të kryeni punimet.
- Detaje të prerjes tërthore të rrugës ose kur ka vepra arti, (ura, etj), menyra e kalimit ne to.
- Relacion teknik i punimeve që do të kryhen.
- Preventiv i veçantë për punimet në trupin e rrugës ose pjesët përbërëse të saj.
- Plani i Menaxhimit të Trafikut per periudhen e nderhyrjes.
- I gjithë materiali ne CD ne POWER POINT
- Garanci punimesh prej 10% të preventivit të punimeve në trupin e rrugës, e cila do të kthehet pas mbarimit të afatit të garancisë së punimeve dhe marrjes në dorëzim nga specialistët e A.Rr.Sh-së së bashku me specialistët e Drejtorisë së Rajonit Rrugor, të cilët do të ndjekin ecurinë e punimeve.
- Pagesë 10% e preventivit të punimeve për përdorimin e rrugës (e pakthyeshme). Kjo fature merret prane Drejtorise se Standarteve.